

Komuna e Drenasit: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Drenasit, zyrtarisht njihet si Komuna e Glllogocit.¹ Komuna e Drenasit që nga paslufta është udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Nexhat Demaku ka shërbyer si kryetar komune në dy mandate. Në zgjedhjet e 2009, PDK ka arritur të marrë 24 ulëse në Kuvendin Komunal (KK), nga 31 sa janë gjithsej, ndërsa partitë opozitare kishin siguruar numrin më të madh të pjesëmarrjes në Kuvend që nga paslufta: me nga dy asamblistë janë të përfaqësuar Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lidhja e Demokratike e Dardanisë (LDD). Ndërsa nga një përfaqësues kanë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Partia e Drejtësisë (PD).²
2. Komuna e Drenasit përbën pjesën qendrore të Kosovës dhe është e populluar nga 59.752 banorë.³ Sipërfaqja e gjithëmbarshme e kësaj komune përfshin 290 km² apo 2.66 për qind të sipërfaqes së territorit të Kosovës⁴. Komuna përbëhet nga 42 vendbanime.
3. Në bazë të hulumtimeve të UNDP, 51% e qytetarëve të Komunës së Drenasit janë shprehur të kënaqur me punën e kryetarit të komunës. Kjo përqindje në Drenas është dukshëm më e ulët se mesatarja e përqindjes së kënaqshmërisë së qytetarëve të komunave të tjera me kryetarët e komunave e cila është 69%.⁵ Kënaqshmëria e qytetarëve me administratën komunale është më e ulët në Drenas (54%), në krahasim me mesataren e komunave të tjera (63%). Një përqindje e lartë (68%) e banorëve të Drenasit besojnë se autoritetet e tyre lokale kanë kapacitet për të zgjidhur

¹ Në këtë raport do ti referohemi si Komuna e Drenasit.

² Komuna e Drenasit. Profili i këshilltarëve komunal. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/glllogoc/Municipality/Assembly/Keshilltaret-Komunal.aspx>

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

⁴ Komuna e Glllogocit, <http://kk.rks-gov.net/glllogoc/>

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP. "Mozaiku i Kosovës". 2012. Fq 50.

Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

problemet në komunën e tyre, kurse 23% e tyre mendojnë se këto probleme mund të zgjidhen vetëm nga pushteti qendror.⁶

4. Sipas hulumtimeve të GAP para zgjedhjeve lokale të 2009, problemet kryesore të cilat i shqetësonin qytetarët e Komunës së Drenasit ishin: Ndotja e ambientit, mungesa e aktiviteteve rinore, mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, administrata, infrastruktura e dobët shkollore, mungesa e infrastrukturës rrugore në shume vendbanime.⁷

Problemet kryesore të Komunës së Drenasit 2013

1. **Mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm.** Komuna e Drenasit problem kryesor ka furnizimin me ujë të pijes. Në fshatrat Abri, Tërstenik dhe Nekofc mungon rrjeti i ujësjellësit, ndërsa në fshatin Korroticë e Ulët dhe Zabel i Ulët edhe pse kalon ujësjellësi përgjatë tyre, banorët nuk janë të kyçur.⁸ Kjo për faktin se gypi kryesor i instaluar është me një distancë të madhe nga shtëpitë e banimit dhe familjet nuk kanë mundësi investimi për t'u kyçur në gypin kryesor. Ato vende të cilat janë të lidhura me ujësjellësin përballen me reduktime të shumta të ujit. Reduktimet gjatë verës shkojnë deri në 10 orë gjatë ditës. Në bazë të hulumtimit të UNDP-së, vetëm 10% e familjeve në Drenas që janë të lidhura me ujësjellësin publik kanë furnizim të pandërprerë me ujë të pijes. Kjo përqindje është tejet e vogël në krahasim me komunat e tjera, ku mesatarja ka dalë të jetë 42%. Sipas këtij hulumtimi, 22% e qytetarëve të Komunës së Drenasit kanë pasur ndërprerje të furnizimit me ujë për 1 deri në 4 orë në ditë, 40% prej 5 deri në 10 orë në ditë, kurse për 13% ndërprerjet e furnizimit me ujë janë më të gjata se 11 orë në ditë.⁹

2. **Vërshimet dhe ndotja e lumit "Drenica".** Mungesa e një sistemi të kanalizimit që mund të përballojë reshjet, si dhe mos zgjerimi i lumit Drenica që kalon edhe nëpër qendër të Drenasit, janë bërë shkaktarë të vërshimeve. Shirat kanë shkaktuar përmbytje në lagjet e qytetit që janë përsëri lumit, por edhe në fshatrat

⁶ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. "Mozaiku i Kosovës". 2012. Fq 50. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

⁷ Instituti GAP. Nëntor 2009. Drenas, raporti komunal. Fq 7. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/65726_Drenasi-raporti%20komunal%20final.pdf

⁸ Për këtë problematikë është raportuar edhe në media. Agjencia e Lajmeve "Koha". Tersteniku, prej dy muajsh ka krize për ujë. 18.08.2012. Burimi: <http://koha.net/?page=1,31,111882>

⁹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. "Mozaiku i Kosovës". 2012. Fq 48. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

Tërstenik, Qikatovë e Re, Shtrubullojë e Komoran, duke i izoluar për kohë të caktuara edhe familjet dhe duke dëmtuar ato. Përveç kësaj, lumi Drenica që përshkon komunën e Drenasit është i ndotur nga hedhja e mbeturinave si dhe derdhja e kanalizimeve në shtratin e tij.¹⁰

3. Mbeturinat. Menaxhimi i mbeturinave mbetet një prej problemeve madhore në Drenas. Mungesa e kontejnerëve nëpër fshatra ka ndikuar në formimin e deponive ilegale të mbeturinave të cilat janë prezente sidomos përgjatë magjistrales Drenas-Skenderaj. Pothuajse çdo fshat i Drenasit ka të paktën nga dy deponi të egra të grumbullimit të mbeturinave të cilat e ndotin mjedisin. Disa prej deponive më të mëdha janë në fshatin Poklek i Ri, e që gjendet 2 km larg Drenasit dhe ajo të “Qukat” në Komoran, afër tregut të kafshëve, në të cilat hidhen kryesisht mbeturinat e lokaleve të biznesit.¹¹ Komuna e Drenasit, kompania “Pastrimi” dhe organizata gjermane GIZ me një projekt të përbashkët kanë shpërndarë 1.200 kontejnerë të përmasave familjare në Komoran dhe Tërstenik. Por, projekti ka dështuar për arsye se banorët nuk kanë pranuar të paguajnë 4.5 euro për kompaninë “Pastrimi”. Në bazë të hulumtimit të UNDP-së, 32% e banoreve të Drenasit konsiderojnë se qyteti i tyre është i skajshmërisht i papastër, ndërsa 42% e konsiderojnë lagjen apo zonën e tyre si të papastër.¹²

4. Ndotja e ajrit. Edhe pse “Ferronikeli” e ka minimizuar ndotjen në masë të madhe për shkak të vendosjes së filtrave, prapë qytetarët ankohen në kualitetin e ajrit.¹³ Prania e gurëthyesve në Komunën e Drenasit e ka rënduar gjendjen edhe më shumë. Aktualisht në Drenas janë aktiv 6 gurëthyes, ku tre prej tyre janë të vendosur në Korroticë të Lartë, një në Qikatovën e Vjetër, një në Baicë dhe një në Sankoc. Në bazë të hulumtimit të UNDP-së, banorët konsiderojnë ndotjen si njërin ndër problemet me të theksuara. Rreth 37% e banorëve të kësaj komune vlerësojnë se ndotja është e madhe.¹⁴

¹⁰ Për këtë problematikë është raportuar edhe në media, shih: Agjencia e Lajmeve “Koha”. “Kontaminohet Uji, ngordhin peshqit.” 25.06.2012. Burimi:

<http://www.koha.net/index.php/player.swf%3Fcid%3D1,15,42501?page=1,13,104704>

¹¹ Për këtë problematikë është raportuar edhe në “Gazeta JnK”. Gazeta “Jeta në Kosovë”. 17 maj 2013. Autorë, Mërgime Ujkani. Deponitë ilegale të mbeturinave në fshatrat e Drenasit. Burimi:

<http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,5583>

¹² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosoves”. 2012. Fq 49.

Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

¹³ Agjencia e Lajmeve “Evropa e Lirë”. 21.06.2012. Autorë, Ariana Kasapolli. Burim:

<http://www.evropaelire.org/content/article/24621689.html>

¹⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosoves”. 2012. Fq 49.

Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

- 5. Pamundësia e kyçjes në rrjetin e kanalizimit.** Një problem tjetër me të cilin përballen banorët e Komunës së Drenasit është mungesa e sistemit të kanalizimit, problem ky që po ndikon në ndotjen e mjedisit dhe shpërndarjen e ujërave të zeza. Rrjeti është shpërndarë nëpër pika të caktuara të lagjeve dhe fshatrave. Për pasojë, shumë familje nuk janë kyçur në kanalizim, shkaku i kostos që ka ardhur nga distanca e madhe mes shtëpive dhe rrjetit të kanalizimit. Kjo është hasur në fshatrat Gllanasell, Gllobar, Tersteniku, Verboci, Gradica, Likoshani dhe Shtutica.
- 6. Infrastruktura e dobët e shkollave.** Komuna e Drenasit ka bërë përmirësime të dukshme sa i përket rritjes së numrit të shkollave. Vetëm fshatrat Poklek i Ri dhe Poklek i Vjetër kanë nevojë për një shkollë, pasi nxënësit mësimin e vijnë në Drenas ose në fshatin Vasilevë. Por, problem paraqet gjendja e rëndë e inventarit tek disa prej shkollave. Shkolla fillore “Gjeladin Gashi-Plaku” në Komoran është në gjendje të keqe dhe ka nevojë përrenovim të tërësishëm, ashtu sikurse edhe shkolla tjetër në fshatin Kishnarekë. Ndërsa shkollat në fshatin Tërstenik dhe Vërboc, përveç që janë në gjendje të keqe aty ka mungesë të ujit dhe mungesës së lidhjeve të nyjave sanitare. Nxënësve u duhet që të marrin ujë nga shtëpitë e tyre, apo të blejnë atë, pasi shkolla nuk ja mundëson furnizimin me ujë të pijshëm.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Liqenet e Vasilevës.** Një varg liqenesh artificiale ndodhen në fshatin Vasilevë, në pjesën e maleve të Gospojës që kufizojnë komunën e Drenasit me atë të Fushë-Kosovës. Në këtë pjesë, që frekuentohet shumë nga banorët gjatë vikendeve, por edhe nga peshkatarët, nuk janë lejuar deri tash të ndodhin ndërtime, apo të zhvillohet ndonjë biznes. Qasja është e zorshme deri tek liqenet, shkaku që komuna nuk ka investuar për ndërtimin e një rruge deri tek to.
- 2. Festivali i këngës dhe valles shqipe.** Ngjarja më e rëndësishme kulturore e organizuar në Drenas ndër vite është Revista e Folklorit Burimor Shqiptar, një festival mbarëkombëtar i këngës e valles shqipe. Për herë të parë, festivali është mbajtur në vitin 1961 dhe ka pasur karakter tradicional. Për çdo vit, qyteti është gjallëruar në 5 ditët sa ka zgjatur festivali. Më shumë se 50 ansamble të ndryshme nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Lugina e Preshevës, Çamëria e Mali i Zi, e madje edhe nga viset e


arbëreshëve të Italisë, kanë performuar në secilin edicion. Janë prezantuar ritet e zakonet, këngët e ndryshme epike, lirike e historike. Për shkak të rrethanave, festivali ka pushuar aktivitetin gjatë viteve të '90-ta, ndërkaq pas luftës, për shkaqe të mungesës financiare, organizimi i festivalit është vënë në vështirësi. Vetëm pak edicione janë organizuar. I fundit është mbajtur në vitin 2010. Qytetarët kanë shprehur dëshirën që festivali të organizohet për çdo vit dhe që organet komunale t'i kushtojnë më shumë vëmendje kësaj ngjarje.

Trendet Buxhetore në Komunën e Drenasit

Komuna e Drenasit për vitin 2013 ka planifikuar 9.6 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010, buxheti kësaj komunë është rritur për 1.6 milion euro. Nga viti 2010 të hyrat vetanake janë rritur, në vitin 2012 komuna e Drenasit ka pasur 868 mijë euro të hyra vetanake. Në bazë të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm sfidë për komunën e Drenasit mbetet mbledhja e borxheve të vjetra. Në vazhdim të mungesës së një databazë të përditësuar me listën e bizneseve aktive, Komuna gjithashtu nuk ka një softuer për regjistrim të të hyrave.¹⁵

¹⁵ ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Drenasit, Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KDR_2012_Shqip_284366.pdf


Figura 1. Buxheti i Komunës së Drenasit 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?drenas/2013#/~/drenas>

Në bazë të grafikonit të mëposhtëm ku paraqiten trendet e ndarjeve buxhetore për vitin 2011-2013 shohim se ndarjet kanë mbetur pothuajse të njëjta me përjashtim të një rënie të lehtë prej 12% të investimeve kapitale gjatë vitit 2013. Kur jemi tek shpenzimet, Raporti Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012 ka gjetur se Komuna ka hyrë në obligime pa fonde të mjaftueshme si dhe janë shpërblyer me kontrata operatorë të cilët nuk kanë plotësuar kërkesat ligjore të prokurimit publik.

Figura 2. Ndarjet Buxhetore 2011-2013



Komuna e Drenasit vlerëson se në vitin 2016 do t'i rris të hyrat për 1.9 milion euro (20%). Kjo rritje pritet të financohet kryesisht nga rritja e grantit qeveritar.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave 2014-2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	10.982.419	11.282.083	11.520.372
Të hyrat vetanake	1.050.000	1.081.500	1.103.130
Grantet	9.932.419	10.200.583	10.417.242

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Drenasit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.